



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo		CAA
Nr. i:	2020/ZDP/369	
Tipi:	2+4	24.12.2020
Statut:		
Hyrje:		
Dalje:		
Brenda:		

Nr. 10/ZDP/VE/2020

Datë: 24 dhjetor 2020

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 4 qershor 2008), nenit 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019"), nenit 13 dhe 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, dt. 10 shkurt 2016 ("Rregullorja") dhe nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 28 prill 2014),

Duke vendosur sipas propozimit final të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("ASHNA"), dt. 07 tetor 2020, për tarifën njësi terminale për vitin 2021,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

VENDIM

1. Refuzohet miratimi i tarifës njësi terminale 2021 prej 495.58 EUR siç është propozuar nga ASHNA më dt. 07 tetor 2020.
2. Përcaktohet tarifa njësi terminale 2021 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 407.00 EUR.
3. Kjo tarifë u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që kjo ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës duke filluar nga data 1 janar 2021.
4. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me qëllim të vlerësimit të propozimit të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2021, AAC-ja ka marrë parasysh dokumentacionin e dorëzuar përgjatë gjithë vitit.

Pas shqyrtimit rregullator të secilës prej kategorive të kostove të propozuara si dhe parashikimit të njësive që pritet të shërbehen gjatë vitit 2021, AAC-ja ka konkluduar që në bazë të fakteve dhe konsiderimeve dhe duke pasur parasysh:

- o Se propozimi i ASHNA-s për tarifën njësi terminale 2021 është në vlerë prej 495.58 EUR dhe nën parashikimin e rritjes së njësive të shërbimit prej 96%;
- o Se ASHNA obligohet sipas Rregullores që të dëshmojë përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit të kostove;
- o Vendimin nr. 05-V-286, dt. 26 maj 2016, përmes të cilit Kuvendi i Republikës së Kosovës ka udhëzuar AAC-në të ndërmarrë masat e nevojshme nga fushëveprimi i vet për të krijuar një konkurrencë më të madhe në funksion të uljes së çmimeve të udhëtimit;
- o Obligimin ligjor të AAC-së për të mbrojtur udhëtarët, mes tjerash duke vendosur një balancë midis operatorëve që japin shërbime nën kushtet e monopolit të natyrshëm dhe atyre që i pranojnë këto shërbime;

- Që industria e aviacionit është në krizën më të madhe në historinë e saj si pasojë e pandemisë së krijuar nga virusi COVID-19;

AAC-ja ka vendosur se:

- Tarifa njësi terminale për vitin 2021 të jetë 407 EUR, respektivisht të mbetet e njëjtë me vitin 2020;
- Nën parashikimin prej 97% të rritjes së numrit të njërive të shërbyera terminale gjatë vitit 2021 në krahasim me vitin 2020, të hyrat që pritet të gjenerohen nga tarifa terminale e navigacionit janë 4.27 milionë EUR;
- Të hyrat e aprovuara për ASHNA-n nga tarifa terminale e navigacionit 2020 (4.27 milionë EUR) dhe të hyrat nga HungaroControl (250,000 EUR) përfaqësojnë të hyra arsyeshëm të mjaftueshme për të mbuluar kostot e pranueshme për të dhënë shërbim cilësor dhe të sigurt gjatë vitit 2021 duke konsideruar rrethanat e jashtëzakonshme të krijuara; dhe

Duke marrë parasysh faktet e cekura më lartë, dhe në pajtim me nenin 15.1 (f), 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, nenin 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si dhe në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Udhëzim mbi mjetin juridik: Në përputhje me nenin 15.7 të Rregullores nr. 3/2016, brenda 7 ditëve nga data e lëshimit të këtij Vendimi, ASHNA mund të ri-dorëzojë për miratim në AAC propozimin e ri për tarifën njësi terminale për vitin 2021 përmes Tabelave të Raportimit dhe narrativit që përshkruan në hollësi kalkulimin e secilës prej kostove të pranueshme dhe dëshmon nevojën për t'u realizuar këto kosto gjatë vitit 2021. Propozimi i ri duhet të dërgohet në origjinal të shtypur dhe në kopje elektronike në AAC.

Iu dërgohet:

- Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Arkivit të AAC-së